



A.nr.2035/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës A.nr.2035/2025, të datës 17.12.2025, të parashtruar nga ankuesi F.L, nga Drenasi, kundër organit të punësimit: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në çështjen juridike “*Transferim*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datë 12.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet** si e pabazuar ankesa me numër A.nr.2035/2025, e datës 17.12.2025, e parashtruar nga ankuesi F.L.
- II. **Mbetet në fuqi** Vendimi me Nr. 02/3401-2025, i datës 25.11.2025, i ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, F.L. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 17.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 02/3401-2025, të datës 25.11.2025, të ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për refuzimin e transferimit të përhershëm të ankuesit në pozitën Zyrtar i Lartë për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa, ky i fundit ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 7914/2025, të datës 17.12.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për parashtrimin e ankesës të datës 17.12.2025; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 22.12.2025; Kërkesë për transferim të përhershëm në institucion e KQZ-së përkatësisht në Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike me Nr.06/2-1093-2525 të datës 10.06.2025; Njoftim-Kërkesë me Nr.0612-

1003/2025 të datës 31.07.2025;Vendim me Nr.02/3401/2025 të datës 25.11.2025; Vendim për Transferimin e Përhershëm të Nëpunësit Civil për Nevoja të Institucionit në një njësi tjetër organizative në kuadër të KQZ-së me Nr.02/1-2971-2025 të datës 22.10.2025;E-mail i datës 11.08.2025;E-mail i datës 04.08.2025; Vendim Për Transferimin e Nëpunësit Civil me Nr.06/2-813-2024 të datës 16.05.2024;Vendim për transferim të përhershëm të nëpunësit me Nr.169-2020 të datës 14.02.2020;Kërkesë për transferim të përhershëm në pozitë të punës brenda Sekretariatit të KQZ-së me Nr.53-2019 të datës 20.01.2020;Kopja e Letërnjoftimit të F.L; Përgjigje në kërkesë Nr.Prot:2035/2025 të datës 30.12.2025;Akt Emërimi i ankuesit me Nr.02/1-1230/2025 të datës 07.07.2025; Formular i Përshkrimit të Punës i datës 18.03.2024; Vendim i KPMSHCK-së, me Nr.Prot:7214/2025 i datës 07.11.2025; Vendim për Miratimin e Rregullores së Brendshme Nr.09/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me Nr.01/45-2024 i datës 18.01.2024; Rregullore e Brendshme Nr.09/2024 për Transferimin e nëpunësve civil në KQZ; E-mail i datës 10.11.2025;E-mail i datës 28.10.2025;Vendim për shfuqizim të vendimit nr.02/1/2971-2025 të datës 22.10.2025;Dorëheqje nga pozita e nivelit të ulët drejtues në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të datës 11.11.2025;Vendim për Sistemim me Nr.02/1-3298-2025 të datës 11.11.2025;Akt Emërimi i V.B-A me Nr.11/2025 të datës 22.10.2025; Vendim për transferimin e Nëpunësit Civil me numër protokoll Nr.0612-813/2024, i datës 16.05.2024; Vendim për transferim të përhershëm të nëpunësit me numër protokoll Nr.169-2020, i datës 14.02.2020; E-mail i datës 27.01.2020.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse:*

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezultojnë se:

- Ankuesi sipas Akt Emërimit me Nr. 06/2025, të datës 07.07.2025, mbanë pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta*, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Më datë 31.07.2025, ankuesi ka parashtruar kërkesë tek organi i punësimit mbi bazën që i njëjti të transferohet në mënyrë të përhershëm në pozitën Zyrtar i Lartë për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike/Njësia për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike.

- Ankuesi më datë 08.09.2025, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa, ky i fundit me Vendimin A.nr.1674/2025 të datës 07.11.2025, ka aprovuar ankesën e ankuesit duke e detyruar Drejtorin Ekzekutiv të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të rishqyrtoj kërkesën e datës 31.07.2025 të ankuesit dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat materiale.

-Ushtruesi i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zbatim të Vendimit të Këshillit A. Nr.1674/2025, më datë 25.11.2025, ka nxjerrë Vendimin Nr. 02/3401-2025, me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesit për transferim nga pozita Udhëheqës i Divizionit për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta në pozitën Zyrtar i Lartë për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike, me arsyetimin se transferimi behët vetëm brenda të njëjtës kategori të shërbimit civil.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me Nr. 02/3401-2025, të datës 25.11.2025, të ushtruesit të detyrës së

Drejtorit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më pretendimet se vendimi i kontestuar më ankesë është në kundërshtim me dispozitat ligjore për shkak që ende pa u kthyer përgjigje në kërkesën e ankuesit është bërë transferimi i Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrim të Dokumenteve në pozitën Zyrtar i Lartë për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet Vendimi me Nr. 02/3401-2025, i datës 25.11.2025 dhe Vendimi me Nr. 02/1-2971-2025 i datës 22.10.2025 dhe të obligohet u.d Drejtori Ekzekutiv të merr vendim për transferimin e ankuesit në pozitën Zyrtar i Lartë për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 6 paragrafi 4, ku përcaktohet se : *“4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë”*, rrjedhimisht, mbi këtë përcaktim ligjor, të punësuarit në kuadër të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë statusit e nëpunësit civil me status të veçantë dhe së KQZ më akt të veçantë ligjor mund të rregulloj çështje nga marrëdhënia e punës së punësuarve të këtij institucioni. Në këtë kuadër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar Rregulloren e Brendshme Nr. 09/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil në KQZ, rrjedhimisht, çështja ankimore do të trajtohet në kuptim të dispozitave të kësaj rregullore dhe Ligjit bazik për zyrtarët publikë.

Nisur nga konstatimi si me sipër, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 64 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më të cilin është përcaktuar se *1. Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunëses/it civil në një pozitë tjetër të shërbimit civil, në rast: 1.1. të paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozitës së mëparshme; 1.2. të shmangies së një konflikti të vazhdueshëm interesi, të përcaktuar me ligj; 1.3. të përfundimit të pezullimit, me kërkesë të nëpunëses/it civil kur ai nuk mund të kthehet në pozitën e mëparshme të punës; 1.4. të shqiptimit të transferimit si masë e pamjaftueshmërisë profesionale; 1.5. të shqiptimit të transferimit si masë disiplinore. 2. Përrjashtimisht, nëpunësja/i civil mund të transferohet përhershëm për interes të institucionit në kategori të njëjtë në shërbimin civil. Ndërsa, Rregullorja Nr. 09/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil në KQZ më nenin 14 paragrafi 1, k paraparë: *“Nëpunësia/i civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme, në vend tjetër të punës, për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil...”*.*

Bazuar në kuadrin ligjor si më lartë, Kolegji nga analizimi i aktit të kontestuar më ankesë ka vërtetuar se Vendimi Nr.02/3401-2025, i datës 25.11.2025, i ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për refuzimin e kërkesës së ankuesit për transferim të përhershëm nga pozita Udhëheqës i Divizionit për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta në pozitën Zyrtar i Lartë për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike, është nxjerrë në pajtim më dispozitat materiale, mbi faktin se pozita e ankuesit si Udhëheqës i Divizionit për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta kategorizohet si pozitë e kategorisë së ulët drejtuese siç parashihet me nenin 38, paragrafi 2, nën paragrafi 2.3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe shtojcën 1/3 të Rregullores së Brendshme Nr. 08/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në KQZ, ndërsa, pozita ku ankuesi ka kërkuar të transferohet pra Zyrtar i Lartë për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike, hyn në kuadër të kategorisë profesionale, andaj, më të drejtë u.d Drejtori i Sekretariatit të KQZ-së ka refuzuar kërkesën e ankuesit për transferim të përhershëm sepse, sipas dispozitave të lartshënuara në rastin konkret nuk janë përmbushur kërkesat ligjore

për transferimi të përhershëm në interes të institucionit, rrjedhimisht, pozita që mbanë ankuesi nuk është e kategorisë së njëjtë më pozitën që pretendon të transferohet.

Ndërlidhur me pretendimin e ankuesit se Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrim të Dokumenteve është transferuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike sipas Vendimit Nr. 02/1-2971-2025 të datës 22.10.2025, të u.d të Drejtorit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave të lëndës ka gjetur se më Vendimin Nr. 02/1-2971-2025 të datës 22.10.2025, zyrtarja V.B. e cila ka mbajtur pozitën Udhëheqëse e Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrim të Dokumenteve ishte transferuar në mënyrë të përhershme në pozitën e Zyrtarit të Lartë për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike, mirëpo, ky vendim është shfuqizuar më Vendimin nr. 02/1-2971/2-2025 të datës 11.11.2025, të ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kurse, më Vendimin Nr. 02/1-3198-2025, të datës 11.11.2025, të ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, zyrtarja V.B, është sistemuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike, pasi që, e njëjta paraprakisht përmes kërkesës Nr. 02/1-3291-2025 të datës 11.11.2025, kishte dhënë dorëheqje nga pozita Udhëheqëse së Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrim të Dokumenteve. Andaj, mbi këto rrethana, sistemi i zyrtares V.B. sipas Vendimit Nr. 02/1-3198-2025, të datës 11.11.2025 është nxjerrë në pajtueshmëri më dispozitat e nenit 75 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më të cilat është përcaktuar se: 2. *Përveç dorëheqjes sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëpunësja/i civil i emëruar në kategorinë e ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese, mund të ofrojë edhe dorëheqje vetëm nga pozita drejtuese që mban.* 3. *Nëpunësja/i civil e kategorisë së ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese që ka qenë në shërbimin civil para emërimit në pozitën për të cilën ofron dorëheqjen si në paragrafin 2. të këtij neni, sistemohet në një pozitë të lirë të kategorisë profesionale me kusht që plotëson kriteret për emërim në pozitën në fjalë...*”

Kështu që, thënë si me sipër e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.2035/2025

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit F.L;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në KQZ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së